



16.03.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jcdmca Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	12019	7

Procesverbali nga konsultimi publik me qytetarë për  
Projekt-Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave  
në Territorin e Komunës së Suharekës

**Konsultimi ka filluar në orën 10:00 është mbajtur në sallën e kuvendit komunal**

**Hapjen e takimit publik për Projekt-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës e ka bërë Avni Bytyqi kryesues I grupit punues.**

Avni Bytyqi: Të nderuar qytetarë, ju falënderoj që jeni bashkë me ne për të diskutuar për Projekt-Rregulloren e Menaxhimit të Mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës. Me ne është Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj. Unë si kryesues I komisionit do të prezantoj para jush Projekt-Rregulloren e Menaxhimit të Mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës e cila ka qenë në konsultim publik, e cila pasataj do të prezantohet para anëtarëve të kuvendit ku do ta merr aprovimin dhe të vazhdohet me impementimin e kësaj rregullore në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti pasi ta merr edhe konfirmimin e ligjëshmërisë nga institucionet kompetente te nivelit qendror.

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunal dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm.

Unë do ti përmendi disa nga specifikat që janë më të rëndësishme dhe nëse keni vullnet ti jepni sygjerimet dhe komentet e juaja në mënyrë që kjo rregullore të jetë sa më e implementueshme dhe e zbatueshme.

Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim: mbeturinat e rrezikshme dhe llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme.

Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent.

Kjo rregullore është bërë duke e respektuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.

Kemi paraparë që sistemi I menaxhimit të mbeturinave të bëhet në dy forma: sistemi i grumbullimit derë më derë dhe në pikat grumbulluese me kontejner-hapësira publike.

Po ashtu kemi bërë edhe kategorizimin e gjeneruesve të mbeturinave, konsumatorët e amvisërive, konsumatorët komerciale/industrial, konsumatorët Institucional.

Në këtë rregullore është I përfshirë edhe përcaktimi i tarifës për grumbullimin e mbeturinave komunale Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit si dhe në këste, nga 3 mujore brenda vitit:

Kësti parë Janar - Mars

Kësti i dytë Prill - Qershor

Kësti i tretë Korrik- Shtator

Kësti i katërt Tetor-Dhjetor

Tek qeshtja e tarifav komerciale apo industrial kemi bere nje rritje me të madhe por mendojm qe eshte e perballueshme. Shpresoj që nuk kam harru diçka, po gjithsesi ne jemi ktu për me ju dhanë sqarime për të gjitha pyetjet e juaja të cilat i keni për këtë rregullore.

Bali Muharremaj: Përshendetje për të gjithë të pranishmit që janë këtu faleminderit për pjesëmarrje.

Ne si Komunë kemi krijuar ndërmarrjen lokale Eko Theranda ku komuna do të marrë komplet menaxhimin e mbeturinave dhe shumë shpejtë do të jetë e funksionalizuar, këtë vitë kemi ndarë 200 mijë euro nga buxheti për blerjen e paisjeve.

Salih Elshani: sipas rregullores a është komuna përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave apo shkon në bazë të tenderit sepse neni nuk është I qartë?

Avni Bytyqi: Komuna do të marrë komplet menaxhimin e mbeturinave, por së pari do të rregullohet infrastruktura ligjore për ndërmarrjen lokale Eko Theranda.

Sadri Kadolli: Në Suhareke po bëhen shumë ndertime pse nuk tarifohen të gjitha a keni bërë ndonjë analize?

Avdyl Kabashaj (u.d menaxher I Eko Regjionit): Bizneset nuk po marrin përgjegjësi kur po fillojnë ndertimet, kemi pas shumë veshtersi gjatë inkasimit do të mundohemi që kur të përfundoj regjistrimi I adresav komplet do të bëhen në bazë të numrave të shtëpive.

Florinda Isufaj: a do të ishte më mire te bëhet pagesa online për arsye se jo të gjithë qytetarët kanë kohë me dal me pagu fizikisht?

Avdyl Kabashaj: Eshte planifikur por këtë vite nuk është paraparë

Takimi përfundoi në ora 10:55.



*Lista e pjesëmarrësve e qytetarëve, mediave të informimit, OJQ-ve dhe pjesëmarrësve tjerë në konsultimin publik me qytetarët për Projekt-Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës të mbajtur me datën 06.03.2026*

Nr.	Emri dhe mbiemri	Përfaqësues	Kontakti	Nënshkrimi
1.	Shyqerije Kuci	Qytetarë	049 258 - 854	
2.	Suadja Bimsteci	Institucion	049 21 8380	
3.	Florinda Sufaj	Institucion	049 311 109	
4.	Alluhana Kuci	Institucion	049 399 510	
5.	Verdite Haxhiqaj	Qytetarë	/ /	
6.	Ismet Sedulli	Qytetarë	/ /	
7.	Salih Ekhami	OJQ	049 950 278	
8.	SADRI KADOLU	ERQ-REGION	049 933-154	
9.	FLORIM HALITAJ	Qytetarë	049 186-904	
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				
16.				
17.				
18.				